

Statistikat e transportit

Dhjetor 2019

Tiranë, më 27 Janar 2019: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Dhjetor 2019 është 354 mijë ton, duke u rritur 5,9 %, krahasuar me Dhjetor 2018.

Në vitin 2019, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 4,5 milionë ton, duke u rritur me 14,5 %, krahasuar me vitin 2018.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin Dhjetor është 419 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 83,4 %, krahasuar me Dhjetor 2018.

Në vitin 2019, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 19,2 milionë ton-kilometër, duke u ulur me 6,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Dhjetor 2018	334.561	2.532	231
Dhjetor 2019	354.387	419	247
Ndryshimi vjetor (%)	5,9	-83,4	7,1
Janar- Dhjetor 2018	3.889.509	20.415	2.245
Janar- Dhjetor 2019	4.455.033	19.181	2.372
Ndryshimi vjetor (%)	14,5	-6,0	5,7

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Shënim: Volumi i mallrave sipas transportit hekurudhor në Dhjetor 2019 rezulton me 83,4 % rënie krahasuar me Dhjetor 2018, për shkak të mungesës së karburantit në hekurudhën shqiptare.

Në muajin Dhjetor 2019, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 247 ton mallra, duke u rritur me 7,1 %, në krahasim me Dhjetor 2018.

Në vitin 2019, me ajër janë transportuar 2.372 ton mallra duke u rritur 5,7 %, krahasuar me vitin 2018.

Numri i fluturimeve të kryera, në Dhjetor 2019 është 2.330 duke shënuar një rritje me 17,8 %, ndaj Dhjetor 2018.

Për publikim 27/01/2020

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Dhjetor 2018	15	1.978	9.930
Dhjetor 2019	17	2.330	10.275
Ndryshimi vjetor (%)	13,3	17,8	3,5
Janar- Dhjetor 2018	15	25.510	176.130
Janar- Dhjetor 2019	17	28.695	188.032
Ndryshimi vjetor (%)	13,3	12,5	6,8

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Dhjetor 2019 është 78.600 pasagjerë. Krahasuar me Dhjetor 2018, ky tregues është rritur 0,7 %. Në vitin 2019, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjë detare 1.574.095 pasagjerë, duke u rritur me 3,4 %, krahasuar me një vit më parë.

Në muajin Dhjetor 2019, transporti ajror i pasagjerëve zë 77,5 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në vitin 2019 është 3.338.147 pasagjerë duke u rritur me 13,3 %, krahasuar me vitin 2018.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Dhjetor 2018	2.405	78.060	227.261
Dhjetor 2019	257	78.600	271.659
Ndryshimi vjetor (%)	-89,3	0,7	19,5
Janar- Dhjetor 2018	75.881	1.522.896	2.947.172
Janar- Dhjetor 2019	59.787	1.574.095	3.338.147
Ndryshimi vjetor (%)	-21,2	3,4	13,3

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Shënim: Numri i pasagjerëve sipas transportit hekurudhor në Dhjetor 2019 rezulton me 89,3% rënie krahasuar me Dhjetor 2018, për shkak të mungesës së karburantit në hekurudhën shqiptare.

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Dhjetor 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 77,4 mld lekë dhe 50,5 % e tyre u transportua me det.

Në vitin 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 947,8 mld lekë dhe 51,9 % e tyre u transportua me det.

Tab. 4 Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Mënyra e transportit	Eksport (mln lekë)				Import (mln lekë)			
	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Jan.-Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Jan.-Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019
Transport detar	12.939	13.139	182.885	176.827	26.833	25.968	323.301	314.583
Transport hekurudhor	2	0	11	4	615	168	4.136	4.190
Transport rrugor	8.192	8.400	113.393	116.897	26.162	25.633	280.102	283.523
Transport ajror	148	88	1.672	1.385	2.607	2.191	19.120	20.865
Të tjera	361	264	12.475	3.665	3.862	1.532	14.805	25.905


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eksportet e mallrave

Në Dhjetor 2019, mallrat e eksportuara me det zënë 60,0 %, me rrugë 38,4 % dhe me ajër 0,4 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur me 2,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Në vitin 2019, mallrat e eksportuara me det zënë 59,2 %, me rrugë 39,1 % dhe me ajër 0,5 %. Në vitin e vitit 2019, mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 3,1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Dhjetor 2019



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Importet e mallrave


Në Dhjetor 2019, mallrat e importuara me det zënë 46,8 %, me rrugë 46,2 % dhe me ajër 3,9 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Dhjetor 2019 janë ulur me 2,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Në vitin 2019, mallrat e importuara me det zënë 48,5 %, me rrugë 43,7 % dhe me ajër 3,2 %.

Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 1,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Dhjetor 2019



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi lëvizjen e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve të transportit, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë